



A.nr.524/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari, dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.524/2026, të datës 12.05.2026, të parashtruar nga ankuesja S.SH, nga Gjakova, kundër organit të punësimit: Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 29.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.524/2026, të datës 12.05.2026, të parashtruar nga ankuesja S.SH.

II. Lënda bartet për shqyrtim dhe vendosje në Komisionin e Ankesave të Komunës së Gjakovës.

A r s y e t i m

Ankuesja S.SH, (*me tej referuar vetëm ankuesja*), me datë 12.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndaj njoftimit të datës 20.04.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të Komunës së Gjakovës për përfitimin e pagës së 13-të për vitin 2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, **sepse**:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se pa të drejtë i është i refuzuar pagesa e 13-të, sepse, e njëjta ka qenë mësimdhënëse e gjuhës angleze, dhe mbi këtë bazë është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me punonjësit e tjerë.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës materiale të Këshillit për vendosje lidhur me çështjen në procedurë ankimore, Kolegji i Këshillit i u referua dispozitave të nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin përcaktohet se: *Kategoritë e zyrtarëve publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe përformuesja/i e/i artist dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit. 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është*

zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunëse/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunëse/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë. 3. **Nëpunësja/i i shërbimit publik** është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës...” rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezultojnë se të gjithë të punësuarit në kuadër të institucioneve publike arsimore të Kosovës, përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, andaj, duke qenë se pretendimet ankimore të ankueses i referoheni periudhës ku ankuesja ka ushtruar pozitën e mësimdhënës, Kolegji konstaton se Këshilli nuk ka kompetenca lëndore për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, sepse, pozita mësimdhënës hynë në kuadër të kategorisë së nëpunësve publik.

Në kuptim të udhëzimit të palës ankuese lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji vë theksin të neni 8 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 27 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se : *Nëpunësi i shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë tek Komisioni i Ankesave i themeluar nga punëdhënësi, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës. Qeveria pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor përcakton procedurën dhe rregullat për themelimin, përbërjen dhe mandatin e Komisionit të Ankesave, pra, zyrtarët publikë të kategorisë së shërbimit publik dhe të kategorisë administrative mbështetëse, në rast të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre nga marrëdhënie e punës, fillimisht mund të parashtrojnë ankesë tek punëdhënësi i cili themelon një Komision të Ankesave në pajtim me kërkesat ligjore, e më pastaj, duke ju referuar përcaktimeve ligjore sipas nenit 77 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, mund të ushtrojnë padi në gjykatën kompetente duke ndjekur procedurën e paraparë me nenin 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës ku shprehimisht thuhet se: **Neni 79, paragrafi 1 “... 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Neni 79 paragrafi 1: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente...”***

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.524/2026, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesja nuk ka parashtruar ankesë

të brendshme pranë organit të punësimit, atëherë, bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.5/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda i delegohet për shqyrtim dhe vendosje Komisionit të Ankesave të Komunës së Gjakovës.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.524/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses S.SH;*
- *Komunës së Gjakovës; Komisionit të Ankesave dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*